REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

Numri i lëndës: 2018:029953
Datë: 11.08.2020
Numri i dokumentit: 01057845

P.nr.643/17

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA KAÇANIK, Gjyqtari Burim Çaka, procesmbajtësja Suzane Rudi, në rastin penal kundër të pandehurit I.B nga Hani Elezit, për shkak të veprës penale: Vjedhje nga neni 325 paragrafi 1 të KPRK–së, sipas aktakuzës PP/II.2123-6 të datës 23.10.2017, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor, jo publik, më datë 30.07.2020, në praninë e Prokurorit të Shtetit Paulin Pashku dhe të pandehurit mori dhe publikisht shpalli, ndërsa më datë 11.08.2020 përpiloi këtë:

A K T GJ Y K I M

I pandehuri: I.B nga Hani Elezit rruga .... , i lindur më datë ...., nga i ati B... dhe e ëma H... e gjinisë K..., me numër personal ..., i martuar, prind i 4 fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, punon me ujësjellës, i gjendjes së varfër ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës e Kosovës, i pa gjykuar më parë, mbrohet në liri.

ËSHTË FAJTOR

Sepse më datë 13.09.2017 rreth orës 22:30 në Han të Elezit, vendi i quajtur "...", më saktësisht në kompaninë B..., me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm të pasurisë për vehte, ka kryer vjedhje në dëm të të dëmtuarës kompanisë "B...", në atë mënyrë që ka vjedhur: 55 copë fije të armaturës me gjatësi prej 2 metra dhe me diametër f300, me ç'rast i shkakton dëm material të pa përcaktuar.

Me të cilin veprim ka kryer veprën penale Vjedhje nga neni 325 paragrafi 1 të KPRK–së

2018:029954

Gjykata në bazë të nenit lartcekur dhe neneve 2, 17, 38, 39, 42, 43, 45, 69, 70, 71 dhe 72 të KPRK-së, 359, 360, 361 dhe 365 të KPPK-së, të pandehurin e:

G J Y K O N

I. Me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 60 ditëve (gjashtëdhjetë ditëve), ku në mbështetje të nenit 45 par 1 të KPRK-së, dënimi i shqiptuar me burgim me pëlqimin e të pandehurit i zëvendësohet me punë në dobi të përgjithshme prej 200 orëve (Dyqind) orëve të cilin dënim do ta kryej në afat prej 3 muaj, prej ditës së fillimit të ekzekutimit.

Konform nenit 45 par 2 të KPK-së, Shërbimi Sprovues Republikës së Kosovës cakton llojin e punës që duhet të kryej personi i dënuar, cakton organizatën në të cilën duhet të punoj i dënuari, cakton ditën, javën që i dënuari duhet të kryej punë në dobi të përgjithshme, si dhe të mbikëqyrë e punën në dobi të përgjithshme.

Konform nenit 45 par 4 të KPRK-së, nëse personi i dënuar nuk e kryen punën në dobi të përgjithshme ose e ka kryer vetëm pjesërisht, e njëjta do t'i zëvendësohet me dënim me burg duke llogaritur nga 8 orë të punës për 1 ditë burgim; dhe

Dënim me gjobë në shumë prej 300€ (Treqind euro), i cili dënim do të ekzekutohet në tri këste, në afat prej 3 muajsh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Nëse i pandehuri nuk e paguan kështin me kohë, mundësia e pagesës më këste do të revokohet.

Nëse i pandehuri nuk dëshiron apo nuk do të mund të paguaj dënimin me gjobë, i njëjti dënim do t'i zëvendësohet me dënim me burg duke llogaritur për çdo 20 euro të gjobës me 1 (një) ditë burgim.

II. Pala e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

III. Obligohet i pandehuri që të paguaj shpenzimet e procedurës dhe paushallit gjyqësor të paguaj shumë prej 30 € dhe në emër të Fondit për Kompensimin e Viktimave të Krimit të paguaj shumën prej 30 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Pjesa hyrëse

Prokuroria Themelore Ferizaj ka ngritur PP/II.2123-6 të datës 23.10.2017, kundër të të pandehurit I.B nga Hani Elezit, për shkak të veprës penale Vjedhje nga neni 325 paragrafi 1 të

2018:029954

KPRK–së dhe ka propozuar që i pandehuri të shpallet fajtor dhe t'i shqiptohet sanksion penal konform ligjit në fuqi.

Gjykata duke vepruar sipas kësaj akuze caktoi dhe mbajti seancën e shqyrtimit gjyqësor më datë 30.07.2020.

Seanca nuk ishte publike për shkak të pandemisë Covid 19 dhe vendimit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës KGJK-Nr.85/2020, të datës 29 maj 2020

Pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit, i pandehuri e pranoi fajësinë për të gjitha pikat e aktakuzës.

Prokurori i Shtetit duke shprehur mendimin e tij përkitazi me pranimin e fajësisë dhe gjatë fjalës përfundimtare ka vlerësuar se ekziston baza për pranimin e fajësisë së të pandehurit ngase i njëjti është bërë konform nenit 248 të KPP-së, dhe i ka propozuar gjykatës që të pandehurin ta shpall fajtorë dhe t'i shqipton dënim sipas ligjit.

Vlerësimi i pranimit të fajësisë

Pasi që i pandehuri ka pranuar fajësinë gjatë fillimit të shqyrtimit gjyqësor, gjykata për të vlerësuar pranimin e fajësisë e duke pasur parasysh edhe mendimin e Prokurorit të Shtetit, shqyrtoi me kujdes faktet e parapara nga neni 248 par. 1 të KPPK-së dhe me këtë rast vlerësoi se: I pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit; Pranimi është bërë vullnetarisht; Pranimi i fajit mbështet në faktet dhe prova materiale të rastit konkret dhe atë me provat e paraqitura nga Prokurori i Shtetit të cilat gjenden në shkresat e lëndës, të gjitha këto prova të mbledhura gjatë procedurës hetimore; Akuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Duke vlerësuar në aspektin juridik gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale në bashkëkryerje Vjedhje nga neni 325 paragrafi 1 të KPRK–së, në mënyrë, vend dhe kohë siç është përshkruar në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Rrethane lehtësuese dhe rënduese

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të pandehurin, gjykata vlerësoj rrethanat në kuptim të nenit 73, 74, 75 dhe 76 të KPRK-së, dhe gjeti si rrethanë posaçërisht lehtësuese se i pandehuri e ka pranuar fajësinë, rrethana lehtësuese pendimin e sinqertë dhe real për veprën penale të kryer, faktin se ishte kryefamiljar dhe mbajtës i familjes.
Gjykata nuk gjeti ndonjë rrethanë rënduese, përpos veprimeve që plotësojnë figurën e veprës penale.

Gjykata të pandehurit i shqiptoi dënim me burgim i cili me pëlqimin e të pandehurit u zëvendësua me punë në dobi të përgjithshme duke marrë parasysh faktin se i pandehuri ka bërë

2018:029954

pranimin e fajësisë dhe ka shprehur pendesë për veprën e kryer, ndërsa dënimin me gjobë ia shqiptoi duke marrë për bazë të gjitha rrethanat lehtësuese të gjetura dhe duke u bazuar në minimumin dhe maksimumin e dënimit të parapare. Gjykata vlerëson se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimeve i paraparë në nenin 41 të KPRK-së, përkatësisht dënimi i shqiptuar është plotësisht i justifikueshëm, në përshtatje me rrethanat e kryerjes, rrezikshmërinë e saj dhe të autorëve të saj, që do të shërbej në parandalimin e kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale) si dhe do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimit.

Vendimi për kërkesat pasurore juridike

Vendimi për udhëzimin e palës së dëmtuar në kontest civil, është marrë në bazë të nenit 458 të KPPK-së.

Vendimi për shpenzimet e procedurës

Konform neneve 450 dhe 453 të KPPK-ës, u detyrua i pandehurit që në emër të shpenzimeve procedurale dhe paushallit gjyqësor, në t'i paguaj kësaj gjykate shumën prej 30.00 € dhe atë në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Konform nenit 39 par 3 pika 3.1 të ligjit Ligji Nr. 05/L -036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit gjykata e obligoi të pandehurin të paguaj shumën prej 30.00 € Fondit për Kompensimin e viktimave të krimit dhe atë në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi

Mbi bazën e të dhënave si më lart, në bazë të neneve 248 dhe 365 të KPPK-së, u vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimi

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ
Dega në Kaçanik
P.nr.643/17 datë 11.08.2020

Procesmbajtësja
Suzane Rudi

Gjyqtari
Burim Çaka

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mundet të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.

2018:029954